

57



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
AVOKATURA E SHETIT
ZYRA E AVOKATIT TË PËRGJITHSHËM

Bulevardi " Zogu I ", Ministria e Drejtësisë, Tiranë. Tel & fax : 04-2253 600, email: kabirneti@avokaturashetit.gov.al

Tiranë më 12/07/2011

K A L L E Z I M P E N A L

Kallëzues: Avokatura e Përgjithshme e Shtetit, e përfaqësuar nga Avokate e Përgjithshme e Shtetit znj. Ledina Mandia, me adresë, "Bulevardi Zogu I", Kati VI pranë Ministrisë së Drejtësisë, Tiranë.

Objekti: Kallëzimin e veprave penale të "fallsifikimit të dokumentave" parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal, të veprës penale të "Shperdorimit të detyres" kryer ne bashkepunim parashikuar nga nenet 248 dhe 25 të Kodit Penal , si dhe të veprës penale të "ekspertimit të remë" parashikuar nga nenet 309 e 25 të Kodit Penal.

Baza Ligjore: Nenet 135, 22, 248 të Kodit Penal, 25 e 186 paragrafi dytë i Kodit Penal.
Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për Arkivat".
Rregullorja "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Gjyqesore" miratuar me Urdhërin nr 1836, date 03.04.2001 të Ministrit të Drejtësisë.

Drejtuar: **Z. Hysni Burgaj**
Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit

Z. Shpetim Mucollari
Drejtor i Krimit Ekonomik pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit

Në vëmendje të: **Z. Bujar Nishani**
Ministër i Brendshëm

220

58

I nderuar Z. Burgaj,
I nderuar Z. Mucollari,

Avokatura e Shtetit në referim të nenit 5, pika 1 germa "c" të ligjit nr. 10018 "Për Avokaturën e Shtetit", si dhe të VKM-së nr.392, datë 8.4.2009 "Për miratimin e rregullores "Për marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me Institucionet Shtetërore dhe Entet Publike, rolin e avokatëve të shtetit në gjykim, si dhe normat e posaçme procedurale", në mbështetje të neneve 280 dhe 283 të K.Pr.Penale parashtrohet këtë kallëzim penal për kryerjen e veprave penale, të falsifikimit të dokumentave, të shpërdorimit të detyrës, ekspertimit të rremë etj.

Në këtë kallëzim penal do t'ju parashtrojmë rrethanat e fakteve konkrete ku bazohet kallëzimi, provat me të cilat vertetohen këto fakte, si dhe dispozitat ligjore materiale penale të shkelura.

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës është ngritur një kërkesë padi civile nga disa subjekte pretendues si ish-pronarë, me objekt gjykimi kundërshtimin e vendimeve të Zyrës Rajonale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Durrës (ZRKKP) dhe të vendimeve të Agjencisë Qëndrore të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë (AKKP), që kanë refuzuar kërkesën për njohje dhe kthim të pronësive të pretenduara prej tyre.

Rezulton e provuar se paditësat Ana Mitro, Fotaq Konomi, Vasillaq Goxhomani, Eleni Mima janë trashëgimtarë ligjor të trashëgimlënësve Jorgo Vevecka, Sofie Kolea, Konstadin Mima, Ariadhni Konomi.

Paditësat pretendojnë se nga dokumentacioni ligjor dhe hartografik që kanë depozituar në dosje pranë ZRKK Durrës, provohet se ata disponojnë titullin e pronësisë para vitit 1944 për një sipërfaqe toke prej 28.993.200 m² me kufijtë përkatës.

Kërkuesit i janë drejtuar fillimisht ZRKKP-së Durrës, për njohjen, kthimin dhe kompensimin e pronës së pretenduar. Zyra Rajonale e Kthimit dhe Kompensimit të Pronës Durrës, me vendimet respektive nr. 379, datë 28.01.2007, nr. 380, datë 28.12.2007, dhe nr. 384, datë 04.01.2008 ka vendosur:

Drejtor i Drejtimit të
Kriminalit

"Të mos njohë të drejtën e pronësisë së trashëgimtarëve të subjektit pretendues si të shpronësuar Jorgji Vevecka etj, të cilët përcaktohen në dëshminë e trashëgimisë të dhënë në pikën tre të vendimit, për faktin se këta trashëgimtarë nuk legjitimohen si palë në procesin administrativ, për shkak të mangësive të parashtruara në pjesën arsyetuese të vlerësimeve ligjore si dhe të vendimeve përfundimtare të ZRKKP-së, të cilat ndodhen të administruara në dosjet përkatëse."

Analisti i...

Në mënyrë kronologjike dhe të detajuar paraqesim si më poshtë vijon dinamikën e seci lit vendim të AKKP-ve.

- 59
- (i) ZRKKP të Qarkut Durrës, pasi ka marrë në shqyrtim kërkesën e trashëgimtarëve të subjekteve pretendues si të shpronësuar, me vendimin nr. 172 datë 01.08.2007, u ka njohur atyre të drejtën e pronësisë dhe u ka kthyer në natyrë sipërfaqen e tokës prej 157.2 ha, si dhe ka vazhduar procedurat për njohjen dhe kthimin e diferencës tjetër të pronës së pretenduar.
 - (ii) AKKP Tiranë si organi epror administrativ, pasi ka shqyrtuar vendimin nr. 258 datë 01.10.2007, e ka shfuqizuar vendimin nr. 172, datë 01.08.2007 të ZRKKP Durrës dhe e ka kthyer dosjen për rishqyrtim duke lënë detyrat përkatëse për tu zbatuar (ZRKKP-së Durrës).
 - (iii) Mbi bazën e kërkesës së subjekteve pretendues si të shpronësuar Zyra Rajonale Durrës ka disponuar me vendimin nr. 380, datë 28.12.2007 si më poshtë vijon:

“Mosnjohjen e se drejtës së pronësisë trashëgimtarëve të subjekteve pretendues, si të shpronësuar Jorgo Vevecka, Sofia Kolea, Konstadim Mima, Evdhoqes Goxhomani Ariadhni Konomi (që përcaktohen nga trashëgimitë e trashëgimive të dhënë në pikën tre të këtij vendimi) për pronën me sipërfaqe 1.820.000 m² e ndodhur në fshatin Hamallaj të rrethit Durrës në ZK Nr. 1925, me indekse harte k-34-88-(144-b,146-a,129-d,161-b) me këto kufij: Veriu pasuria nr.49,54/2,133/2 e kanali i hidroforit;Jugu vija ndarëse midia fshatit Rrushkull-Hamallaj; Perendim pasuria nr. 21/8,21/6, Lindje pasuria nr133/2,49,139,146,87.”

- (iv) Ky vendim i mësipërm është lënë në fuqi me vendimin nr. 1069, datë 24.09.2008 të AKKP Tiranë që ka lënë në fuqi mosnjohjen e të drejtës së pronësisë të kërkuesve.
- (v) Me vendimin nr.379, datë 28/12/2007 të ZRKKP Durrës, lënë në fuqi me vendimin nr.1071, datë 24/09/2008 të AKKP Tiranë është vendosur:

“Mosnjohja e të drejtës së pronësisë trashëgimtarëve të subjekteve pretendues si të shpronësuar Jorgji Vevecka, Sofia-Kolea, Kostandin Mima, Evdhoqes Goxhomani, Arjadhni Konomi që përcaktohen nga dëshmitë e trashëgimive të dhëna në pikën 3 të këtij vendimi, për pronën me sip. 25 597 200 m² e ndodhur në fshatin Rrushkull në zonen kadastrave ZK 3241 me indeks harte të papërcaktuar, pasi zona është jashtë sistemit të ZVRPP Durrës, me këto kufij natyral: Veriu prona e vet, Jug lumi Erzen, Perendim deti, Lindje Qani Hanem dhe Fuat Bej Toptani.

- (vi) Me vendimin nr.384 datë 04/01/2008 të ZRKKP Durrës, lënë në fuqi me vendimin nr.1070, datë 24/09/2008 të AKKP Tirane, është vendosur:

“Mosnjohja e të drejtës së pronësisë trashëgimtarëve të subjekteve pretendues si të shpronësuar Jorgji Vevecka, Sofia-Kolea, Kostandin Mima, Evdhoqes Goxhomani, Arjadhni Konomi që përcaktohen nga dëshmitë e trashëgimive të dhëna në pikën 3 të këtij vendimi për pronën me sip.1575900 m² e ndodhur në fshatin Hamallaj të Rrethit Durrës në zonen kadastrale ZK 1925 me indeks harte k-34-88(144-b,129-a,129-b) me këto kufij: Veri pasuria nr. 20/1,21/9, Jug vija ndarëse midis fshatit Rrushkull, Perendim Deti, Lindje pasuria nr.21/9,21/10,134.

- (vii) Duke mos qenë dakord me vendimet e marra nga Zyra Rajonale Durrës (ZRKKP) të lëna në fuqi nga AKKP-ja Tiranë, që kanë refuzuar kërkesat për njohje dhe kthim të pronësive të pretenduara, paditësat Ana Mitro (Vevecka), Fotaq Konomi, Vasillaq Goxhomani, Eleni Mima, si dhe nderhyresat kryesore Polikseni Mima dhe Marieta Mima, kanë ankimuar në rrugë gjyqësore pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës vendimet e mësipërme.

Në kërkesë padi paditësat dhe ndërhyrësit kryesorë kanë paditur ZRKKP Durrës dhe AKKP Tiranë, duke kërkuar;

1. Ndryshimin e vendimeve nr.384, date 04/02/2008 ZRKKP Durrës, nr. 1070, dt. 24/09/2008 te AKKP Tirane që kanë bërë mosnjohje pronësie, duke kërkuar gjyqësisht njohjen e së drejtës së pronësisë dhe kthimin fizik të sipërfaqes së tokës prej 1.575.900 m²;

2. Ndryshimin e vendimit nr.380 date 28/12,2007, te ZRKKP Durrës dhe nr.169 date 24/09/2008 te AKKP Tirane që kanë bërë mosnjohje pronësie, duke kërkuar gjyqësisht njohjen dhe kthimin e së drejtës së pronësisë në natyrë për një sip. Toke prej 1 820 000 m².

3. Ndryshimin e vendimit nr.379, dt. 28/12/2008 te ZRKKP Durrës dhe nr.1071 dt.24/09/2008 te AKKP Tirane që kanë vendosur mosnjohjen e pronësisë, duke kërkuar gjyqësisht njohjen dhe kthimin fizik në natyrë një sip. toke prej 25 597 200 m².

- (viii) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka pranuar kërkesë padinë e paditësave dhe ndërhyrjen kryesore, duke vendosur në disfavor të AKKP-së dhe ZRKKP-së, pra duke anuluar vendimet e pronave dhe duke njohur dhe kthyer pronësitë e pretenduara nga paditësat dhe ndërhyrësit kryesor.

- (ix) Kundër këtij vendimi është ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Durrës, e cila me vendimin e saj nr. 210 datë 14.05.2010 ka vendosur:

“ - Ndryshimin e vendimin nr. (11-2009-4169) 2653, datë 05.10.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës;

- Rrëzimin e kërkesë padisë së paraqitur nga paditësat Ana Mitro, Fotaq Konomi, Vasillaq Goxhomani, Eleni Mima janë trashëgimtarë ligjor të trashëgimlënësve, Jorgo Vevecka, Sofie Kolea, Konstadin Mima, Ariadhni Konomi, dhe ndërhyrësve kryesorë Polikseni Mima, Marieta Mima, me objekt të padisë dhe ndërhyrjes kryesore ndryshimin e vendimeve:

1. Nr.384 daten 04/01/2008 te ZRKKP Durrës, lene ne fuqi me vendimin nr.1070 date 24/09/2008 te AKKP Tirane, duke u njohur të drejtën e pronësisë dhe duke kthyer në natyrë një tokë me sip.1575900 m²
2. Nr.380 date 28/12,2007, te ZRKKP Durrës dhe nr.1069 date 24/09/2008 te AKKP Tirane.

931

61

3. Nr.379 dt. 28/12/2008 te ZRKKP Durres dhe nr.1071 dt.24/09/2008 te AKKP Tirane, si vendime të pabazuar në ligj dhe në prova.

(x) Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës që ka disponuar me vendim në disfavor të paditësave dhe ndërhyrësve kryesorë, është ushtruar Rekurs nga në Gjykatën e Lartë nga paditësit brenda afatit ligjor 30 ditor.

(xi) Gjykata e Lartë me vendimin e saj nr. , datë 14.06.2011 ka vendosur:

"- Prishjen e Vendimit nr. 210, datë 14.05.2010 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe lënien në fuqi të Vendimit nr. 2653, datë 05.10.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës."

.....

Nga studimi dhe analizimi i të gjitha provave shkresore dhe akteve që ne disponojmë vlerësojmë se, Gjykatat janë bazuar në dokumenta dhe prova shkresore të fallsifikuara që nuk kanë asnjë vlerë ligjore pra janë "akte nul dhe inekzistente", dhe që janë administruar në gjykim në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi.

Në rrethanat konkrete, kur janë cenuar haptazi dhe në kundërshtim flagrant me ligjin interesat pasurore të shtetit dhe prona publike, e cila është tjetërsuar në favor të të tretëve pa pasur kërkuesit titull të vjetër pronësie, vlerësojmë se shkeljet që do t'i nënvizojmë më poshtë përbëjnë shkak për fillimin e procedimeve penale ndaj shumë personave që kanë konsumuar elementë të veprave të ndryshme penale. Sipërfaqja e tokës e përfituar nga këta persona në kundërshtim me ligjin është në përmasa galopante.

E vlerësojmë si të domosdoshëm denoncimin në strukturat tuaja të ndjekjes penale, për të vënë përpara përgjegjësisë ligjore cdo punonjës publik që ka konsumuar elementë të veprave të ndryshme penale, pasi me keqardhje konstatojmë veprime dhe shënja korruptive nga shumë persona të cilat kanë shpërdoruar funksionet publike të tyre.

Shpresojmë dhe besojmë se, Prokuroria do të na mbështesi në zbardhjen e elementeve që parashtrihen në këtë kallëzim penal, me qëllim vënien përpara drejtësisë të të gjithë autorëve dhe personave përgjegjës që kanë abuzuar haptazi me ligjin.

PROVAT QË KËRKOJMË TË HETOHEN PENALISHT, TË DEPOZITUARA NGA SUBJEKTET:

I. Akt gjykimi nr. 52 datë 12.03.1946 i Gjykatës së Prefekturës Durrës.

1.1 Gjykata Durrës e ka konsideruar të mirëqenë vendimin nr. 52 datë 02.03.1946 të Gjykatës së Prefekturës Durrës, në të cilin është shpallur i pavlefshëm testamenti i lënë nga Z.Miltiadh Shallvari në favor të znj. Sllava Ljubica Amalia Lampo dhe ka njohur si bashkëpronar Jorgo Vevecka, Sofie Kolea, Konstadin Mima, Ariadhi Konomi. Nga përmbajtja e akteve të administruara në seancë gjyqësore, konkretisht të këtij akt gjykimi krijohet bindja e bazuar në prova se akti gjykimit nr 52, datë 02.03.1946 i Gjykatës Durrës është i fallsifikuar.

Në ndryshim nga vendimet e tjera gjyqësore të volumit të vendimeve nga është nxjerrë ky akt gjykimi i vjetër (të cilat rezultojnë të kenë nënshkrimin e gjyqtarit dhe sekretares gjyqësore) vendimi në fjalë nuk përmban as firmën e gjyqtarit dhe as atë të sekretares gjyqësore dhe as vulën e institucionit të kohës, për të provuar autenticitetin e vendimit.

1.2 Vendimi gjyqësor nr 2, datë 12.03.1946 i Gjykatës Durrës i administruar gjatë gjykimit civil në cilësinë e provës shkresore (madje me fuqi të plotë provuese si prova bazë e origjinës së pronës së kërkuesve) nuk ka marrë formë të prerë, e njëkohëshisht nuk është firmosur e vulosur nga kryesekretari i Istitucionit, gjë që të krijon bindjen e arsyeshme se akti gjykimit nuk ekziston dhe është tërësisht i fallsifikuar, ose ky akt mund të ekzistojë, por jo në variantin e paraqitur nga palët, pasi edhe me sy të lirë konstatohet se është ndërhyrë në akt.

1.3 Konkretisht akti gjykimit (vendimi vjetër) që ka tre faqe, në krye të faqes së fundit (që përmban dispozitivin) përmban shënimin "Faqe -3- Ky shënim mungon në faqen e dytë megjithëse për koherencë duhej të ekzistonte edhe në faqen 2 edhe në atë të fundit, ose në asnjërën prej tyre.

1.4 Në librin e vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në ndryshim nga vendimet e tjera të këtij libri dhe praktika e kohës e cila vazhdon deri sot, ku vendimet kanë nënshkrimin e gjyqtarit dhe sekretares, ky vendim nuk është origjinal, por një vendim i vërtetuar nga sekretarja, dhe mbi të gjitha nuk mban nënshkrimin e gjyqtarit të çështjes. Gjithashtu, konstatohet qartësisht se edhe nënshkrimi i sekretares gjyqësore në këtë vendim, krahasuar me nënshkrimet e tjera të kësaj sekretarje në vendimet e tjera gjyqësore nuk është e njëjtë.

1.5 Trashëgimlënësi Miltiadh Shallvari kishte fëmijë dhe në kushtet kur testamenti i tij është shpallur i pavleshëm, nuk kishte arsye përse nuk është thirrur në atë gjykim si palë trashëgimlënësja e tij, vajza zj. Edita Shallvari. Ky fakt hedh edhe një herë dyshimin e arsyeshëm mbi pavërtetësinë e aktit të gjykimit.

1.6 Fakt tjetër domethënës që hedh dyshime mbi pavërtetësinë (fallsitetin) ose mbi ekzistencën ose jo të vendimit gjyqësor të cituar më sipër është edhe mosregjistrimi në indeksin e vjetër i emrave të palëve ndërgjyqëse të vendimit nr. 52, datë 02.03.1946. Përse i përket vendimeve të tjera të vjetra gjyqësore të kohës, rezulton se janë pasqyruar rregullisht identitetet (emer, mbiemër) e palëve ndërgjyqëse për cdo çështje që është gjykuar. Në regjistrin e vjetër të indekseve të çështjeve civile të Gjykatës Durrës, (shiko indekset e viteve 1945 - 1950 dhe 1945 - 1968), nuk gjenden të indeksuara emrat e palëve ndërgjyqëse të vendimit 52, datë 02.03.1946, dhe nuk gjendet as regjistrimi i aktit nr. 2, viti 1945.

1.7 Duke e parë dokumentin me sy të lirë krijohet bindja e arsyeshme se shkrimi në dy faqet e para nuk është i njëjtë me atë në faqen e fundit. Konkretisht, germat e faqes së fundit duken qartësisht më të mëdha nga ato të dy faqeve të para si nga forma dhe madhësia e shkronjave. Gjithashtu, konturet e germave në faqen e fundit janë më të pastra se ato të faqeve të tjera, çfarë krijon përshtypjen se janë shtypur nga makina shkrimi të ndryshme.

1.8 Gjykata e Apelit Durrës e cila ka rrëzuar padinë, ka hetuar në lidhje me Vendimin nr. 52 datë 02.03.19946, i cili ka kontestuar testamentin e lënë nga z. Miltiadh Shallvari në favor të znj. Sllavia Ljubica, Mario Amalia Lampo, ku ka rezultuar i pa rregjistruar në hipotekë, dhe i panënshkruar nga gjyqtari e për rrjedhojë nuk ka prodhuar efekte juridike. Nga ana jonë janë trajtuar dhe po i trajtojmë përsëri disa prova dhe dokumenta të cilat provojnë pa asnjë ekuivok se Vendimi nr. 52 datë 12.03.1946 është i fallsifikuar.

Në vendim, në faqen e dytë paragrafi 3 nga rrjeshti 20 deri në atë 30 thuhet shprehimisht se, " Sëmundja mendore e testatorit provohet pa asnjë dyshim me deponimet e dr.A.Hobdarit, Dhimitri Vokopolës, si dhe me gjithë dëshmitaret e anës paditëse, të cilët kanë pasur kontakt me të. Kjo deduktohet edhe nga deponimet e dëshmitarëve Ali Fehmiut, dhe Bilie Penpei, që e padituna ka caktuar sepse këto e paraqesin si një njeri që vuante prej manies së persekutimit. Po ashtu edhe me certifikatën datë 30. 11. 1939 të Prof.Nikola De Paskale vertetohet se testatori qysh prej vitit 1926 filloi të vuante nga mendja. Pra kolegjit Arbitrar nuk mbetet asnjë dyshim se testatori në kohën e redaktimit të testamentit nuk ka pasur mendje të saktë".

1.9 Nga dokumentacioni i Arkivit Qëndror të Shtetit rezulton e kundërta e përmbajtjes së Vendimit nr. 52 datë 12.03.1946, pasi dëshmitarët janë shprehur si më poshtë:

- Në lidhje me thëniet e dr. Nikola de Paskale, nga Procesverbali i mbajtur nga pretori dhe Kryesekretari të seksionit të dytë të preturës Napoli ku thuhet: " vizitova për herë të parë..... Në vitin 1927 Shallvari filloi të ndjente shqetësime nervoze gjenerike dhe mbas keshillave të mia shkoi në vjenë, ku i vizitue dhe u kurue prej një specialisti domethan prej Prof.Vaguer, me kurat e të cilit i-u kthye shendeti i mir. Në kohën e-mëpastajme dhe-me-sa-më-kujtohet-aty afër 1930 dhe mbasandaj Sallvari pësoj prap fenomene nervoze ma të forta se ata të cfaquna më parë dhe që moren karakter marrëzie. Para kësaj kohe dhe më 1929 ai kishte fuqi mendore të qartë dhe gjykuese, megjithëse për shkak të karakterit të tij disa herë kishte pasë qaste hidhërimi të shkaktueme sidomos prej ngeljes së infeksioneve malarike që kishte masë."...
- Raporti i Dr. Konstantinidhit, i cili në tërësinë e tij theksohet se Miltiadihi gjatë vitit 1929 ka qenë fare mirë nga mendja dhe ka ruajtur fuqinë mendore të plotë deri më 1930, si dhe në një periodë të vitit 1931 dhe vetëm nga viti 1932 u keqësua dhe me gjithë këtë, sic dëshmon edhe Dr. Bonvicini në letrën që kemi paraqitur, ka pasur intervale të qarta.....
- Dëshmitari që ka marrë pjesë në aktin e depozitimit të testamentit, Srefan Kacukinin që përjashton cdo anormalitet të Miltos, në atë kohë, Don giuzeppe Grillo-n, i cili ka bërë një deklaram me be simbas rregullave kanonike, të legalizuar dhe prej Vakirit të Arhidioqezës Udines.
- Kol.av Pompeo Bilio i cili ka njohur Milton për shume vite deri në 1929 dhe verteton se jo vetëm ka qenë krejt normal por edhe shume i zoti për të mbrojtur interesat e veta dhe këtë e ka vertetuar me rastin e kontratës së qiradhënies të Rushkullit më 1929.....
- Procesverbali nr. 940 prot datë 08.07.1940, ku Gjykata e shkallës së parë Elbasan ka zbatuar letër porosinë e Gjykatës së rrethit gjyqsor Durrës, për pyetjen e

dëshmitarit Dud Gjecin gjyqtar paqtues në Gramsh në lidhje me dijeninë që kishte mbi të ndjerin Milto Shallvari, nëse në vitin 1929 ka ndodhur i cmendur dhe nëse këtë anormalitet e ka pasur qysh para redaktimit të një testamenti të lëshuar prej tij në favorin e Jorgji e Sofie Vevecka për një cifik në Rrushkull.

Nga ky procesverbal kuptohet se dëshmitari në fjalë ka qënë gjyqtar dhe kryente dhe detyrën e Noterit në Gjykatën e Durrësit, dhe shprehet se: *"...në vitin 1929 ka dorëzuar prej z.Milto Shallvari një testament ollograf në praninë e dëshmitarve z. Torenc Tocit, Ndrek Kacarosit etj, , dhe nuk konstatova se z. Shallvari të kishte ndonjë anormalitet mendor mbasi po të kishim konstatuar ndonjë mungesë të tillë do të veproja ndryshe...."*

- 1.10 Nga Verifikimi ynë në Volumin e Vendimeve gjyqësore të vitit 1946 rezulton se në Arkivin e Gjykatës nuk ndodhet vendimi origjinal nr. 52 datë 12.03.1946, por një vendim i fotokopjuar. Po ashtu dhe Kancelarja ka nxjerrë në cilësinë e provës një akt i cili nuk ishte origjinal, por i fotokopjuar dhe që nuk mbante nënshkrimin e gjyqtarit dhe sekretarit gjyqësor, duke shkelur ligjin mbi arkivat dhe Rregulloren e brendshme të gjykatave të miratuara nga Ministri i Drejtësisë.
- 1.11 Kancelarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, ka bërë shënimin: **“Është i njëjtë me atë që ndodhet në volumin e vendimeve”**, duke shkelur dispozitat ligjore të ligjit mbi arkivat si dhe Rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e administratës gjyqësore”.
- 1.12 Konkretisht ka shkelur nenin 12 të ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat”, i cili thotë:

“Dokumentet që dalin nga organi shtetor duhet të kenë: Stëmën e Republikës, intestimin “Republika e Shqipërisë”, emërtimin e organit shtetror dhe strukturës përkatëse (nëse ka ligj), nr. e rregjistrimit të korrespondencës (mod.1), vendin dhe datën, shkurtimin e lëndës, adresën e korrespondentit, formulën “në përgjigje” ose “vijim të shkresës (kur është rasti), nr. e lidhjeve kur ka, tekstin e dokumentit dhe nënshkrimin e tij, si dhe vulën. data dhe nr. I protokollit vendosen pas firmosjes nga titullari.

Ekzemplari i dokumentit që mbahet në sekretari apo sekretari-arkiv siglohet edhe nga nëpunësi edhe nga perpiluesi dhe përgjegjësi i sektorit. Në të shënohet dhe sasia e ekzemplarëve të shtypur. Kur dokumenti është i daktilografuar, kuvendit të Shqipërisë, Presidentit, Këshillit të Ministrave e Gjykatës Kushtetuese u dërgohet kopja e parë”.

- 1.13 Neni 11, pika 7, 8 germa “c” e Rregullores “Për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Gjyqësore”, miratuar me Urdhërin e të Ministrit të Drejtësisë nr. 183 6 datë 03.04.2001 parashikon shprehimisht se:

Kancelari, në fushën procedurale, ushtron kompetencat si vijon:

...7. Lëshon, vërteton dhe nënshkruan akte procedurjale që dalin nga gjykata për të realizuar veshjen administrative të aktit procedural.

8. Nënshkruan të gjitha aktet procedurjale që kërkojnë shënime procedurjale sikurse janë: c. ekstrakte, fotokopje të vërtetuara me origjinalin që dalin nga gjykata”.

II. Vërtetimi i pronësisë i datës 09.11.2005 nga dokumentat hipotekor, “notë transkriptimi nr. 465, datë 20.02.1940” është tërësisht i fallsifikuar në përmbajtjen e tij.

2.1 Sipas këtij vërtetimi në rregjistrin hipotekor nr. 465, datë 20.02.1940, figuron e rregjistruar në pronësi të Jorgo Vevecka, Sofie Vevecka (Kola), Konstadin Mima pasuria Ciflik Rrushkull me kufij P-deti, Veri-Qorrallitë, Fuat Bej Toptani dhe Zija Bej Toptani, Lindje- Qani Hanem, Fuat bej Toptani, Jug- Shoqëria EIAA, Lumi Erzen.

2.2 Nëse krahasojmë këtë vërtetim me notën e transkriptimit të cilit i referohet, këto të dyja ndryshojnë tërësisht nga njëra-tjetra.

2.3 Nga materiali rezulton se, pas ngritjes së padisë Gjykata e Shkallës së Parë Durrës me shkresën nr. 9 i aktit C, ka kërkuar transkriptimin e kopjes së kërkesë padisë të Jorgo Vevecka etj, kundra Nikolla Shallvarit etj që ka shkuar në Gjykatën Kolegjale për njohje trashgimie dhe pjesitim pasurie të ciflikut Rrushkull.

Nëpunësi i Hipotekës e ka transkriptuar në datën 20 shkurt 1940, volumi 12 faqe 55 nr.rradhori 465.

2.4 Nota e transkriptimit nr. 465, datë 20.02.1940 permban rregjistrimin e një kërkesë padie të Jorgo Vevecka, Sofie Vevecka (kola) Konstadin Mima, kundra trashëgimtarve Miltiadh Shallvari dhe nuk përbën mënyrë të fitimit të pronësisë dhe nuk është aspak vërtetim pronësie sic ka dashur ta deformatë pala paditëse. Konkretisht regjistri hipotekor i asaj kohe shprehet:

“...në favor të paditësavet 1Jorgo Vevecka i biri i të ndjerit Sotir banues në Tiranë, 2. Sofia e bija e të ndjerit Sotir Vevecka e shoqja e Kol Kolës banuese në Vlorë, 3. Konstadin Spiro Mima banues në Tiranë – Kondra të paditurve 1. Nikolla Konstadin Shallvari, i ndodhun në Itali me banim të paditun, 2. Lubica(Maria) Amalia Kampo, e veja e Milto Shallvarit me banim të paditunEvdhoqia e bija e Leonidha Kolës e shoqja e Kristi Gozhomanit banues në Berat Kërkojmë transkriptimin e kopjes së kërkesë padisë të Jorgo Vevecka e tj Kundër Nikolla Shallvarit Et, që bani në Gjykatën Kolegjale për njohje trashëgimie dhe pjesitim të ciflikut Rrushkull me kufij P-deti, Veri-Qorrallitë, Fuat Bej Toptani dhe Zija Bej Toptani, Lindje- Qani Hanem, Fuat bej Toptani, Jug-Shoqëria EIAA, lumi Erzen.. Prandaj kërkojmë transkriptimin e sipërm.”

2.5 Pra nga sa më sipër, provohet se kjo padi është rregjistruar në Hipotekë (si padi që bën fjalë per pretendime për të drejta reale mbi nje pasuri të pa lujteshme) , duke iu permbajtur rregullave te K.C te vitit 1929 ashtu si dhe rregullat që ekzistojnë sot. Neni 197/2 KC parashikon se :

“cdo padi që ka të bëjë me të drejta reale mbi nje pasuri të pa lujteshme rregjistrohet në ZRRPP-“si inskriptim” mbi pronën”. Por kjo nuk do të thotë se me këtë rregjistrim paditësi është pronar i pronës së pretenduar pa një vendim gjyqësor të formës së prerë të ekzekutuar në mënyrë vullnetare ose të detyrueshme nga zyra përmbartimore. Pikërisht, paditësat dhe me këtë kërkesë padi të rregjistruar në Hipotekë të Durrësit jane prezantuar si bashkëpronarë të këtij rregjistrimi (të kërkesë- padisë) dhe e kanë paraqitur në KK Pronave “si vertetim bashkëpronësie, gjoja bashkzotnues mbi këtë pronë duke përfshirë edhe trashgimlënësen e tyre Penelopi Vevecka.

2.6 Nisur nga sa më sipër arrijmë në konkluzionin se **Vertetimi i pronësisë i datës 09.11.2005 është tërësisht i fallsifikuar**. Duke qënë në dijeni të këtij fakti subjektet e interesuara e kanë përdorur në Agjensinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe në rrugë gjyqësore si dokumentin bazë të origjinës së pronës së tyre.

2.7 Nga praktika dhe nga zbatimi ligjit për rregjistrimin e pasurive të paluajtshme, rezultojnë dy sisteme rregjistrimi në sistemin e vjetër të rregjistrimit të hipotekës dhe sistemin e ri të rregjistrimit (me kartela dhe harta treguese). Në rastin e parë nuk jepet **“certifikatë për vertetim pronësie”** për arsye se pasuria në fjalë nuk i është nënshtruar procedurave të rregjistrimit fillestar, prandaj në këtë rast në vend të “certifikatës për vërtetimin e pronësisë” lëshohet një “vertetim hipotekor” në të cilin janë pasqyruar të dhëna nga dokumenti hipotekor dhe rregjistrat përkatës.

Nga kjo rezulton se regjistruesi (nëpunësi i Hipotekës) ka shkelur ligjin për rregjistrimin e pasurive të paluajtshme, pasi ka ndryshuar përmbajtjen e dokumentit duke e prezantuar si **“vertetim pronësie”** për palët e ineteresuara, duke deformuar rregjistrimin e kërkesë-padisë që nuk është mënyrë fitimi pronësie (sipas aktit 465 të vitit 1940). **Regjistrimi i kërkesë - padisë në rregjistrat e hipotekës është një “barrë” mbi pasurinë ose një “kufizim” mbi të drejtën reale të pronësisë dhe jo titull pronësie.** Ky vertetim pronësie i lëshuar nga hipoteka ka sjellë pasoja shumë të rënda për interesat pasurore të shtetit, pasi me një dokument krejtësisht të fallsifikuar është disponuar mbi pronën publike dhe shtetërore padrejtësisht në një sipërfaqe prej rreth 29.43 hektar tokë.

III. **Në lidhje me vërtetësinë e aktit të ekspertimit të bërë nga ekspertët dhe që është marrë i mirëqenë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës.**

3.1 Ekspertët e caktuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësorë Durrës gjatë vërtetimit të faktit juridik të pronësisë dhe në gjyqin e themelit ka marrë si të mirëqenë faktin se kërkesë- padia e transkriptuar në rregjistrat e hipotekës përbën vërtetim pronësie dhe nuk është ndaluar aspak në faktin se kjo kërkesë- pasi është një barrë mbi pasurinë dhe jo një mënyrë fitimi pronësie. Mbi bazën e kësaj kërkesë padie ekspertët kanë bërë përlllogaritjen e sipërfaqes, duke deformuar faktet dhe provat.

Në akt-ekspertim, ekspertët ishin të detyruar të jepnin mendimin teknik mbi sipërfaqet pronë publike që nuk mund të tjetërsohej tek të tretët si brezi ranor deri në det, apo kënetat që janë kthyer, cka provon se kanë abuzuar në mënyrë haptazi flagrante me ligjin.

Këto janë prona publike që në vështrim të ligjit "Për Rezervat Ujore" si dhe ligjit "Për pronat e paluajtshme të shtetit", nuk mund të njiheshin dhe ktheheshin në natyrë për shkak të dispozitave ndaluese të ligjit. Ishte detyrë e ekspertëve të përcaktonin sipërfaqet që s'mund të ktheheshin në natyrë për shkak të ndalimit në ligj.

3.2 Gjatë vertetimit gjyqësor të faktit nga Gjykata Durrës është thirrur eksperti Vasil Gjoni për të përcaktuar sipërfaqen që duhet njohur dhe kthyer në favor të kërkesve. Referuar vërtetimit të pronësisë dt 13.03.1993 në favor të Jorgji Vevecka, Sofie Vevecka, Konstadin Mima, Nikolla Shallvari, Lubica Amalija Lampo eksperti ka konturuar për njohje dhe kthim një sipërfaqe prej 2943 hektar. Të njëjtën shkelje kanë bërë nëpërmjet relacionit të përpiluar prej tyre inxhinieri topograf Gjon Coku dhe Vaid Bleta ku dhe këta japin të njëjtën sipërfaqe.

3.3 Ekspertëve që kanë përpiluar aktin e ekspertimit gjatë vendimit nr. 2653 datë 05.10.2009, u janë bërë këto pyetje;

- a. Të përcaktohet vend ndodhja konkrete për të treja pronat objekt material i gjykimit për të cilat ka disponuar Z.R.K.K.Pronave Durëes, lidhur me kërkesën e paditësve.
- b. A përputhet vendodhja faktike e pretenduar me përshkrimet e sakta për sa i takon vendndodhjes, sipërfaqes dhe kufizimeve në dokumentat kadastrale të paraqitura si prova nga pala paditëse.
- c. Të përcaktohet gjendja faktike dhe juridike e këtyre pronave lidhur me. Regjimin juridik që zbatohet sot në to, faktin nëse është disponuar për ndonjë pjesë të këtyre pronave më parë nga KK Pronave apo Komisionit të Ndarjes së tokës, faktin nëse këto prona janë të lira apo të zëna me ndërtime të cisko natyre qofshin.

Nga përgjigjia e Ekspertëve na rezulton se sipërfaqja e pronës është si më poshtë:

- Tokë pa frut, rrugë e kanale S=250 hektar,
- Sipërfaqe pyjore S=337.5 hektar,
- Sipërfaqe ranore S=136 hektar,
- Tokë kënetë e mocale S= 255 hektar,
- Tokë bujqësore e troje S=1334.5 hektar,
- Tokë truall S=300 hektar.
- Sipërfaqja e përgjithshme është 2613 hektar.

3.4 Ekspertët kanë hartuar një akt ekspertimi dhe një shtesë akti ekspertimi, që nuk përputhet me gjendjen faktike në terren. Kjo referuar edhe korrespondencave të ardhura nga ALUIZNI, Ministria e Mjedisit, dhe nga Komuna Sukth.

Në aktin e ekspertimit nuk është sqaruar se sa është sipërfaqja e liqenit Bishtarakës, sa është sipërfaqja e kënetës, sa është zonë e mbrojtur bregu i detit ? ...etj.

- 3.5 Ekspertët duke mos i trajtuar këto që sipër cituam, kanë konsumuar elementë të veprës penale të “Ekspertimit të rremë”.
- 3.6 Nga këto dy akte ekspertimi të administruara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës rezultojnë dy sipërfaqe të ndryshme njëra 2943 ha dhe tjetra 2613 ha, ku në asnjërin akt nuk rezulton të jetë evidentuar i qartë rregjimi juridik i pronave objekt ekspertimi nëse janë të zëna apo jo sipas ligjit dhe cilat duhet të ktheheshin dhe cilat jo.

IV. Ana objektive e kryerjes së veprës penale.

Për të analizuar *elementin e anes objektive te kryerjes se veprave penale nga ekspertët* është e domosdoshme të thirret një grup ekspertesh topograf te Institutit Gjeografik Ushtarak Tirane, të cilëve duhet t’iu vihen në dispozicion materialet dhe provat shkresore që ndodhen në dosje dhe në Arkivin e Shtetit. Ekspertët që duhet të thirren duhet t’iu japin përgjigje të saktë dhe profesionale pyetjeve mbi regjimin juridik të pronave, origjinës së pronave dhe nëse përbëjnë dokument të saktë që prezanton titullin e pronësisë, sipërfaqen brenda kufijve të vendosur etj.

Pasi të jetë kryer një hetim i plotë nga ana e Drejtorisë së Kriminologjisë, i cili të mbështetet në aktin shkencor të ekspertimit me specialistë të fushave përkatëse, si dhe pas verifikimit të gjithë provave të paraqitura nga ana jonë, besojme se organet e zbatimit të ligjit do të provojnë shkeljet flagrante që kanë sjellur pasoja shumë të rënda për interesat pasurore të shtetit, vlera e të cilave varion në miliona euro.

V. Subjektet e veprës penale.

Persa i perket *Subjekteve te veprave penale*, rezultojnë se janë të gjithë personat që kanë kryer funksionet publike në vendimmarrje, Administrata e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, punonjësit ZVRPP Durrës, ekspertet që kanë ndihmuar në kryerjen e këtyre veprimeve të finalizuara më pas me daljen e vendimit.

VI. Ana subjektive e veprës penale.

Persa i perket *anes subjektive te veprave penale*, nga hetimi administrativ i kryer nga ana jonë nuk mund të arrijmë në një konkluzion të qartë, por kjo është pjesë e procesit dhe hetimit penal. Vlera jashtëzakonisht e madhe e pronës së njohur dhe kthyer, pa pasur subjektet e interesuara që tërheqin

interesa pasurore origjinë prone provon në mënyrë të qartë, elementin e dashjes dhe sjelljet korruptive që kanë pasjellë tjetërsimin e pronave publike dhe shtetërore, veprime të cilat janë kryer nga rrethi i personave të sipër përmendur.

VII. KONKLuzioni

Në përfundim të parashtrimit të fakteve dhe rrethanave të përshkruara më sipër, ligjit penal të aplikueshëm në rastin konkret dhe analizës së plote ligjore të veprimeve të kryera nga të kallëzuarit arrijmë në konkluzionin se disa punonjës të administratës shtetërore dhe ekspertë të ngarkuar nga ligji për dhënien e mendimit të specializuar, në bashkëpunim me njëri-tjetrin kanë kryer veprat penale të parashikuara nga nenet 248 e 25 të Kodit Penal si dhe 135 186 paragrafi 2 të po këtij Kodi.

Bashkëlidhur këtij kallëzimi penal gjeni provat shkresore dhe aktet e tjera provuese:

- Vendimi nr. 52, datë 12.03.1946 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.
- Vërtetim pronësie datë 19.01.1994 i Hipotekës Durrës.
- Fletë rregjistri, vol 12 - faqe 55, me shënim transkriptimi nr. 465 datë 20.2.1940.
- Vërtetim nga Dokumenti Hipotekor datë 09.11.2005.
- Kopje të akteve të ekspertimit të bëra nga ekspertët e caktuar nga gjykata.
- Kopje të dokumentacionit të dalë nga arkivi që vërtetojnë se Miltiadh Shallvari ka qenë e rregullt mendërisht.

AVOKAT I PËRGJITHSHËM I SHTETIT

